



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Grafo Loni" të datës 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Grafo Loni" dt. 26.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin dt. 24.05.2023 të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Grafo Loni" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik N.T.SH. "Grafo Loni" (tutje "parashtruesi) me datë 26.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në - Rivlerësim" me nr. të prokurimit 616-23-1251-1-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Prandaj janë plotësuar kushtet për shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinës 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

Pretendimi i parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. **Pretendimi i parë** – *“AK-Konkretisht komisioni i vlerësimit ka shkelur nenin 1 qellimi pasi që nuk i ka shfrytëzuar në mënyrë efikase buxhetin e shtetit duke shpallur fitues OE me të shtrenjte”.*
- II. **Pretendimi i dytë** – *“AK, nuk ka vepruar në mënyrë të barabartë për faktin se edhe pse kemi kryer furnizime të ngjajshme, ne jemi eliminuar padrejtësisht nga gara”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 60 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 01.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimin e parë (I)** fillimisht duhet cekur se kriteri i dhënies së tenderit në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Në rastin konkret është respektuar në tërësi ky kriter pasi që është rekomanduar për kontraktë pikërisht tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Duhet theksuar se është tërësisht jorelevant fakti nëse ka pasur tender të tjerë të papërgjegjshëm të cilët ka mundur të ofertojnë me çmimin më të ulët. Kjo për arsye se të njëjtit janë eliminuar për shkak se kanë qenë të papërgjegjshëm dhe jo për shkak të çmimit që kanë ofertuar. Në rastin konkret parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm dhe për këtë arsye ky pretendim i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

**Lidhur me pretendimin e dytë (II)** nga dosja e tenderit është gjetur se në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional një nga kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që duhet të dëshmojnë tenderuesit është *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 100,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontrate”*. Komisioni i rivlerësimit ka gjetur se parashtruesi nuk e plotëson këtë kërkesë për faktin se disa nga kontratat dhe referencat që ka dorëzuar parashtruesi nuk janë kontrata fare të ngjashme me aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ofertuar. Parashtruesi pretendon se është dashur të merret parasysh edhe kontrata e lidhur me Komunën e Graçanicës me titull *“Furnizim me rekvizita dhe pajisje sportive”* si dhe kontrata e lidhur me Komunën e Prishtinës me titull *“Furnizim me pajisje infografike në objektet e Komunës së Prishtinës”*. Në këtë drejtim duhet cekur se aktiviteti i prokurimit për të cilin ka ofertuar parashtruesi ka të bëjë me furnizim me inventar shkollor dhe nuk ka të bëjë fare me rekvizita sportive apo me pajisje infografike. Pra që nga titulli vërehet se këto aktivitete të prokurimit nuk kanë fare ndërlidhje me njëra tjetra. Rrjedhimisht edhe për nga përmbajtja e tyre këto kontrata janë të një natyre krejt tjetër prej aktivitetit të prokurimit ku ka ofertuar parashtruesi. Furnizimi me pajisje infografike është diçka tjetër, pastaj edhe furnizimi me rekvizita sportive është diçka tjetër, mirëpo furnizimi me inventar shkollor është tërësisht diçka tjetër. Nga ky këndvështrim komisioni për rivlerësim me të drejtë nuk ka marrë parasysh

këto dy kontrata pasi që të njëjtat nuk janë fare të ngjashme me aktivitetin përkatës të prokurimit sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit të cituar më sipër. Për këto arsye edhe ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.06.2023

Visar SHEHU  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.